3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës 1. Cdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.

2. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës 1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës	
Shtojca 2. Lista e Çmimeve të Sherbimeve	
Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës	
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial.....	
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike	
Shtojca 6. Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit	
Shtojca 7. Termat e referencës	
Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve	
Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....	
Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit	
Shtojca 11 - Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)	
Formulari 12 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)	
Shtojca 13 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)	
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)	

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**;
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**;

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Shërbimet)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: Shërbime të mbikqyrjes së punimeve.

Afatet e ekzekutimit: Sipas loteve

Loti I: "Mbikqyrja e punimeve për objektin: "Rikualifikimi urban i zonës informale që kufizohet nga rrugët Sabaudin Gabrani - Jonuz Rama - Hamdi Çullhaj - Damian Himarioti - Bari Ishka - Vasfi Samini - Alush Elmaz Taka", 10 (dhjetë) muaj kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për të njëjtin objekt

Loti II: "Mbikqyrja e punimeve për objektin: "Rehabilitimi i Emergjencës Civile, Ura e Gurrës dhe muret mbajtëse, fshati Qinam, Njësia Administrative Zall-Herr", 16 (gjashtëmbëdhjetë) javë kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për të njëjtin objekt.

Loti III: "Mbikqyrja e punimeve për objektin: "Rehabilitimi i Emergjencës Civile me beton arme 'Përroi dhe rruga e Parrosës', fshati Dritas, Njësia Administrative Zall-Herr", 16 (gjashtëmbëdhjetë) javë kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për të njëjtin objekt.

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Mbikqyrja e punimeve për 3 objekte të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2023:

Detyrat: Mbikqyrësi i punimeve do të kryej shërbimin e mbikqyrjes në përputhje me detyrimet e përcaktuara në udhëzimin Nr.610, datë 22.09.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementët e përgjithshëm të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, si dhe vkm Nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, "për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”

Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit.

Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, në çdo rast, kur gjatë mbikëqyrjes së punimeve, sipas fazave përkatëse, konstaton mospërputhjen e punimeve të kryera me lejen e ndërtimit, me dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, urdhëron pezullimin e punimeve të ndërtimit dhe njofton menjëherë Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të bashkisë ku kryhen punimet e ndërtimit dhe autoritetin përgjegjës të planifikimit ose, sipas rastit, edhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Loti I: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: **“Rikualifikimi urban i zonës informale që kufizohet nga rrugët Sabaudin Gabrani - Jonuz Rama - Hamdi Çullhaj - Damian Himarioti - Bari Ishka - Vasfi Samini - Alush Elmaz Taka”**”.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Lista e çmimeve të shërbimeve sipas Shtojcës 2;
- c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- d. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- e. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 8 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativë ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. *Shënim:* Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor,

organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

- b. Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).
- c. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 dhe 2023 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formularin e vlerësimit për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shenohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formular vlerësimi/vërtetim për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes ku të shënohet vlera, afati i kontrates dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar si dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontraten e bashkimit të operatoreve dhe prokuren e posacme, të deklaruara në fazën e tenderimit.
- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën baze ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontraten e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçensë profesionale** për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi:

- N.P- 1 Punime gërmimi në tokë;
- N.P- 4 Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- N.P- 7 Ujesjelles, Kanalizime, vepra kullimi e vadtije.

N.P-11	Ndertime per nenstacione, kabinat e transformacionit, linjat T/N dhe tensionit te mesem dhe shperndarjes se energjise.
N.P- 12	Punime të inxhinierisë së mjedisit;
N.S- 6	Sinjalistika, Rrugore jo ndricuese
N.S - 18	Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës.

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensë profesionale për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

3. Një punësim mesatar i të paktën 10 (dhjetë) personave, për periudhën të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

3.1 Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

3.2 Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi për per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

4. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të mbikqyrjes, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi

5. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar për:

a) 1 punonjës i pajisur me çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme,

Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë")*.

b) 1 punonjës specialist "Ekspert Zjarrefikes në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim" në përputhje me Ligjin Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate dhene nga Drejtoria MZSH, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert Zjarrefikes në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim")*.

c) 1 (një) punonjës i pajisur me certifikate "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga shoqëria të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave")*.

Shënim: Për stafin e kërkuar sipas pikës 4 dhe 5, operatorët ekonomikë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojnë emër, mbiemër, profilin e punës, numër, datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i diplomës/ kualifikimit, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO të sipercituar)*.
- b) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO të sipercituar)*.
- c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO të sipercituar)*.
- d) Çertifikatën e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor ISO 39001-2012 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 39001-2012.
- e) Çertifikatën e menaxhimit të energjisë ISO 50001-2011 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Shënim: Kandidati ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Loti II: "Mbikqyrja e punimeve për objektin: **"Rehabilitimi i Emergjencës Civile, Ura e Gurrës dhe muret mbajtëse, fshati Qinam, Njësia Administrative Zall-Herr".**

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Lista e çmimeve të shërbimeve sipas Shtojcës 2
- c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- d. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- e. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 8 të DST

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 2(dy) viteve të fundit financiare (2021, 2022) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. *Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.*
- b. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e**

periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

- c. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 dhe për vitin 2023 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formularin e vlerësimit për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formular vlerësimi/vërtetim për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes ku të shënohet vlera, afati i kontratës dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar si dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posaçme, të deklaruara në fazën e tenderimit.
- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën baze ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Licensë profesionale për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”**, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi:

- N.P-1 (Punime gërmimi në tokë)
- N.P-4 (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale)

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se

kategoria e kërkuar, nuk koresponon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës.

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensë profesionale për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

3. Një punësim mesatar i të paktën 5 (pesë) personave, për periudhën të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

3.1 Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

3.2 Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet perkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit)

4. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të mbikqyrjes, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi

Shënim: Për stafin e kërkuar sipas pikës 4 operatorët ekonomik në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojnë emër, mbiemër, profil i punës, numër, datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i diplomës/ kualifikimit, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO të sipercituar).
- b) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO të sipercituar).
- c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO të sipercituar).

Shënim: Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Loti III: "Mbikqyrja e punimeve për objektin: **"Rehabilitimi i Emergjencës Civile me beton arme 'Përroi dhe rruga e Parrosës', fshati Dritas, Njësia Administrative Zall-Herr"**.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Lista e çmimeve të shërbimeve sipas Shtojcë 2;
- c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- d. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- e. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 8 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit financiare (2021, 2022) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. *Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.*
- b. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin

vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

- c. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 dhe për vitin 2023 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

